



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Nr.01-060/01-7888/23 datë:23.03.2023



Npi – 01/113 datë:28.03.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Nenit 36 dhe 37.4 të Statutit të Komunës së Shtimes, 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në mbledhjen e mbajtur më: 28.03.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE
E mbajtur më datën: 28.03.2023 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesja: znj.Besartë Musliu-Spahija, Anëtarët: z.Hasan Avdyli, z.Gëzim Haxhiu dhe z.Reshat Mujota. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe drejtori i DSHMS-së, z.Isa Haxhiu dhe z.Reshat Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit znj.Besarta Musliu-Spahija, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes, për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.02.2023,
2. Informatë nga DSHMS-ë për sektorin e Mirëqenies Sociale,
3. Vizite pune e anëtarëve të Komitetit në Qendrën për Punë Sociale,
4. Informatë mbi gjendjen dhe furnizimin për nevojat që ka Qendra për Punë Sociale.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës, propozoj që pikën 3 të rendit të ditës me e larguar nga rendi i ditës.

z.Reshat Mujota; Edhe unë pajtoj për me e hequr pikën e 3 nga rendit të ditës, dhe pajtoj me pikat tjera të rendit të ditës.

*** Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, unanimisht miratoi rendin e ditës pa pikën e 3 si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 27.02.2023,
2. Informatë nga DSHMS-ë për sektorin e Mirëqenies Sociale,
3. Informatë mbi gjendjen dhe furnizimin për nevojat që ka Qendra për Punë Sociale.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26.02.2023

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, me 4 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstënim” miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e mbajtur më 27.02.2023.**

Pika 2

Informatë nga DSHMS-ë për sektorin e Mirëqenies Sociale

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Fjalën ja dha Isa Haxhiut drejtor i DSHMS-së.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, lexoi Informatën në tersi, në fund pasi lexoi tha informatën do të ja jap sekretarisë së Kuvendit. Nëse ka dikush ndonjë pyetje unë do të përpiqem të përgjigjem (shih dokumentin).

znj.Arbresha Sylja; Përshëndetje, te ndihmat sociale tjera, a na shpjegon pak se për far kategorie tjera po bëhet fjalë?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Janë ata që i mbushin 18 vjet, si dhe ata fëmijë mbi 5 vjeç të cilët e humbin të drejtën e ndihmës sociale.

z.Reshat Mujota; Ne ishim për vizitë pune te QPS-ja, dhe ata në mesin e të tjerave patën edhe ankesën për mungesë të stafit, për 4 vende të punës, e në mesin e tyre edhe drejtori është në mungesë. A ka mundësi që të rritet stafi, dhe të bëhet pagesa e kujdestarisë. A pritet rregullimi i këtyre çështjeve?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; QPS-ja i kanë 10 punëtorë gjithsej, prej tyre tani 3 mungojnë, dy kanë shkuar në pension, dhe një e ka lëshuar vetë punën. Për dy e kemi hap konkursin, e për njërin ende jo. Për sa i përket pagesës së kujdestarisë unë u kam thënë që pagesa të bëhet në formë të kujdestarisë e jo vetëm për orën që vijnë në punë psh. në gjysmën e natës.

z.Reshat Mujota; Bashkëpunimi me Halil Kastratin për ndërtimin e 30 shtëpive për banim, a mund të na njoftoni pak më shumë për këtë?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Po është një bashkëpunim me participim me 8000€ ndërsa Halil Kastrati merr pjesë me 20.000€. Bashkëpunimi është arritur për 3 vite, për ndërtimin e 30 shtëpive të banimit në komunën tonë.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; A po planifikoni për ndonjë shtëpi strehuese për personat delikuent?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Jo kemi marrëveshje me Komunën e Ferizajt, për këtë sepse ata kanë hapësirë të mjaftueshme, për këtë arsye nuk mendoj se kjo ka leverdi ekonomike.

z.Hasan Avdyli; Përshëndetje, është e mirë dhe e domosdoshme me e pas ne një shtëpi të tillë, sepse edhe ka donacione për raste të tilla, sepse kur ndodhë rasti ne duhet me qenë të përgatitur. Është mirë që nuk kemi shumë raste.

z.Reshat Mujota; Rastet të cilat nuk kanë truall për ndërtim, a e humbin rastin për ndërtim apo jo?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Këta persona duhet me bë zgjidhje vetë për truall, sepse Komuna nuk ka tokë për ta.

Pika 3

Informatë mbi gjendjen dhe furnizimin për nevojat që ka Qendra për Punë Sociale

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Fjalën ja dha Isa Haxhiut drejtor i DSHMS-së.

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Ata kanë nevojë për një Gjeneratorë, dhe një veturë. Për furnizimin me Gjeneratorë e kemi planifikuar me buxhet por për veturë tani për tani jo. Në vazhdim z.Isa Haxhiu, lexoi një listë për nevojat e QPS-së.

z.Hasan Avdyli; Nevojat e QPS-së janë të mëdha e të shumta. Por unë po kërkoj nga drejtori që ta fuqizojë QPS-në me rritjen e stafit ashtu siç parashihet me 3500 banorë për një punëtorë social, ndërsa ne jemi larg përmbushjes së standardit. Pozita financiare është e vështirë, dhe kjo e largon stafin nga aty. Problemet sociale nuk janë imun ndaj askujt, për këtë arsye kërkohet një angazhim shumë më i madh dhe më i gjerë.

znj.Arbresha Sylja; Ma merr mendja se vetura do të ju ndihmonte më shumë në kryerjen e punëve. Nëse ata nuk munden me shkua në vendin e ngjarjes, nuk e di se për far shërbimi social

po flasim. QPS-së i duhet me qenë më shumë e fuqizuar, por me e shikuar edhe mundësinë e donacioneve.


z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Pa mirëqenie sociale fatkeqësisht je i sëmurë. E kam të qartë këtë shumë, por për fat të keq nuk perceptohet drejt. Nuk duhet të kuptohet ashtu që QPS-ja është aty vetëm për shpërndarjen e ndihmave sociale. Unë jam për me i përkrahë por u bëj thirrje edhe kuvendarëve që ta përkrahin më shumë QPS-në. Edhe Kryeministri po bën përpjekje për një ristrukturim të Qendrave për Punë Sociale.

Kryesuesja, znj.Besartë Musliu-Spahija; Gjatë vizitës që kemi bërë atje, e pamë se ata kishin nevojë edhe për dritare të reja, a keni paraparë diçka për këtë?

z.Isa Haxhiu, drejtor i DSHMS; Sa e di ata i kanë paraparë 1500€ për këtë destinim por duhet ta shohim më hollësisht.

Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 14:48h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit
Besartë Musliu-Spahija

